



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KSHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr. 866/2 Prot.

Gramsh, më 31 / 03 2026

V E N D I M

Nr. 20 , datë 27/03/2026.

PËR

**MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS PËR PARANDALIMIN DHE MASAT QË DO TË
MERREN PËR MBROJTJEN E PYJEVE DHE KULLOTAVE PUBLIKE, NGA ZJARRET
PËR VITIN 2026.**

Këshilli Bashkiak Gramsh në mbledhjen e tij të datës 27, 03, 2026, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë Gramsh dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Shërbimit Pyjor, mbështetur në KPA në Republikën e Shqipërisë, në ligjin nr.139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin nr.8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", në ligjin nr.107/2014, datë 03.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", në ligjin nr.57/2020 "Për Pyjet", në ligjin nr.9693, datë 19.03.2007 "Për fondin kullor" i ndryshuar, në VKM-në nr.7 nr.684, datë 02.09.2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa të Vendimit nr.433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave, sipas listës së inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive", në VKM-në nr.288, datë 27.06.2002 "Për përcaktimin dhe marrjen e masave kundra zjarrit dhe shpëtimin në objekteve me rëndësi ekonomike dhe shtetërore", në VKM-në nr.290, datë 30.04.2004 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare dhe menaxhimin e zjarreve në pyje e kullota", me shtesat dhe ndryshimet, në VKM-në nr.1080, datë 22.12.2010 "Mbi rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe në kullota" si dhe për krijimin e njëjësive vullnetare të shuarjes së zjarreve, Këshilli Bashkiak;


V E N D O S I :

1. Të miratojë Planin e Punës "Për parandalimin dhe masat që do të merren për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave publike nga zjarri, për vitin 2026" të hartuar nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Shërbimit Pyjor (Sektori i Inspektimit dhe Mbrojtjes së Pyjeve, Kullotave, Tokave Bujqësore) si strukturë përgjegjëse për pyjet dhe kullotat, pranë bashkisë Gramsh.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Shërbimit Pyjor, si strukturë përgjegjëse për pyjet dhe kullotat pranë Bashkisë Gramsh.
3. Ky Plan-Pune, për parandalimin dhe masat që do të merren për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave publike nga zjarri për vitin 2026, hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut Elbasan.

SEKRETARI I KËSHILLIT

XHULIA GJINI



KRYETARI I KËSHILLIT

ENIS ZANI

